

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NOTERE MIMOZA SHEHU  
Nr. Rep...  
Nr. Kol...



## KONTRATE

### PER THEMELIMIN E SHOQERISE ANONIME PA OFERTE PUBLIKE “ LA PETROLIFERA ITALO-ALBANESE” SH.A.

Ne Tirane, sot, me daten 29.07.2002 ( dymijeedy ), dite e hene, te muajit korrik, ketu ne studion time, ne Tirane, ne adresen : Rr.e Durrës, pranë ish-rezidencës së Gjykatës së Rrethit të Tiranës, nr.5, përpara meje noteres Mimoza Shehu, u paraqit personalisht, i interesuari :

1. **Dr.Guido Ottolenghi**, i biri i Emilios, lindur ne Bolonje, Itali, me 25 mars 1966, me zotesi te plote per te vepruar, shtetas italian, banues ne Bolonje, mbajtes i pasaportes nr. 845811, leshuar nga Questura e Bolonjes, me 20 shkurt 2001, i cili ne kete akt nuk vepron ne emer te tij, por per llogari dhe ne perfaqesim te Shoqerise “ LA PETROLIFERA ITALO RUMENA” S.p.A., me qender legale ne Milano, via del Bollo, no.4, me qender administrative ne Bolonje, Viale Aldini, nr. 190, me kapitalin themeltar ne EURO 486 000 ( katerqindetetedhjetegjashtemije presje ze-ro ), teresisht te derdhur, me kodin fiskal dhe TVSH, dhe numurin ne Rregjistrin Tregtar te Milanos 00745880153, Itali; me cilesine e Administratorit te Deleguar, i pajisur me te gjithë pushtetet e domosdoshem, sipas vendimit te Keshillit Administrativ te shoqerise, te dates 23 korrik 2002, i cili, bazuar ne kerkesat e Ligjit nr.8450, date 24.02.1999, “ Per perpunimin, transportimin dhe tregjetimin e naftes, te gazit dhe te nenprodukteve te tyre ”, kerkon nga une, noterja, redaktimin e kesaj kontrate, per themelimin e shoqerise anonime, ne kushtet dhe menyren, si me poshte :

#### Neni 1 Aksioneret

Aksioneri i vetem i shoqerise anonime, “ La Petrolifera Italo Albanese ” SH.A. eshte Shoqeria “ La Petrolifera Italo Rumena “ S.p.A., me qender legale ne Milano ( MI. ), Italia, via del Bollo, nr.4 dhe qender administrative ne Bolonje ( It. ), Viale Aldini, nr.190, me kapitalin themeltar ne EURO 486.000 ( katerqindetetedhjetegjashtemije presje zero ), teresisht te derdhur, me kodin fiskal dhe TVSH dhe numurin e regjistrimit ne Rregjistrin Tregtar te Dhomes se Tregjetise te Milanos 00745880153.

#### Neni 2 Emertimi

Emertimi i shoqerise anonime eshte “ La Petrolifera Italo Albanese” SH.A. Shoqeria eshte pa oferte publike. Emertimi i shoqerise, ne cilendo forme qe te jete formuar, ne aktet dhe dokumentat e saj duhet te permbaje tregimin e shoqerise anonime SH.A. dhe kapitalin themeltar.

#### Neni 3 Qendra legale

Shoqeria ka qendren legale ne qytetin e Tiranës, Rruga e Durrës, nr.1, pranë Tirana Trade Center.



#### **Neni 4 Kapitali themeltar**

Kapitali Themeltar eshte fiksuar ne leke shqiptare 2.000.000 ( dymilion ), te ndare ne 200 (dyqind ) aksione te zakonshme, me vlere nominale prej leke shqiptare 10.000 ( dhjetemije ) secili.

Shoqeria me aksione "La Petrolifera Italo Rumena" S.H.A. zoteron 100 perqind te kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar prej 2.000.000 ( dymilion ) leke shqiptare ka ekuivalencen e tij ne EURO ..... , ditën e nenshkrimt të kesaj kontrate.

#### **Neni 5 Objekti i Shoqerise**

##### **Shoqeria ka per objekt :**

- Depositat, transporti, transformimi dhe perpunimi i produkteve te naftes, kimike, te gazit te lengshem te naftes (GLN), ushqimore, te bitumit dhe te produkteve te lengshem ne pergjithesi, si dhe te gjithe produktet e tjere te paambalazhuar ( ne rifuxho );

- realizimin dhe ushtrimin e veprimtarise se cisternave per depozitim dhe te magazinave bregdetare dhe ne brendesi tokesore;

- studimin, eksperimentimin, projektimin dhe realizimin e ndryshimeve dhe te modernizimeve te impianteve, realizimin e te gjitha iniciativave te drejtimit qe kane lidhje me permiresimin funksional dhe ekonomik te veprimtarise logjistike, duke mbajtur gjithmone parasysh aspektet ekologjike dhe te sigurimit;

Shoqeria ka, gjithashtu, per objekt, jo ne menyre ekskluzive ose prevalente, marrjen persiper te pjesemarrjes ne shoqerite industriale, tregtare, financiare, ne pergjithesi, si ne ato shqiptare ashtu edhe ne ato te huaja dhe, qerane financiare te sendeve te paluejtshem dhe te luejtshem.

Shoqeria, gjithashtu, mund te kryeje cdo dhe cfardo veprimi tregetar industrial, financiar dhe veprime imobiliare, si dhe sa Asamblea ose Keshilli Mbikqyres do t'i konsiderojne te nevojshem per arritjen e objektit te shoqerise .

#### **Neni 6 Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise eshte e percaktuar, deri me 31 dhjetor 2100 dhe, mund te prishet para afatit apo te zgjatet me vendim te asamblese se aksionereve, ne baze te ligjit shqiptar.

#### **Neni 7 Struktura e shoqerise**

Organet e shoqerise jane:

1. Asamblea e aksionereve (aksioneri i vetem),
2. Keshilli Mbikqyres,
3. Drejtoria.

Rregullat e funksionimit, te drejtat dhe detyrimet e tyre parashikohen ne statutin e shoqerise dhe pranohen nga aksioneret (aksioneri i vetem).

**Keshilli Mbikqyres eshte i perbere nga tre ( 3 ) a netare, me nje mandat me kohezgjatje prej dy ( 2 ) vjete :**

1. **Dr.Emilio Ottolenghi**, i biri i Guido-s, lindur ne Torino ( To.), Itali, me 18.01.1932, shtetas Italian, me banim ne Minerbio (BO), mbajtes i Pasaportes nr. 816594L, leshuar nga Kue-stura e Bolonjes, me 30.06.1934, KRYETAR.
2. **Prof.Av.Marco Lamandini**, i biri i Lucianos, lindur ne Bologna ( Bo.), Itali, me 03.07.1966, shtetas Italian, me banim ne Milano ( Mi. ), mbajtes i pasaportes nr 319913B, leshuar nga Kuestura e Bolonjes, me 09.07.1998, ZEVENDESKRYETAR.

3. **Ing. Giancarlo Magnani**, i biri i Armandos, lindur ne Milano ( Mi. ), Itali, me 29.03.1939, shtetas Italian, me banim ne Genova, Itali, mbajtes i pasaportes nr. 096584P, leshuar nga Kuestura e Genoves, me 19.09.1996.

**Drejtoria perbehet nga tre ( 3 ) anetare, te cilet jane emeruar me nje mandat me kohezgjatje prej dy ( 2 ) vjetesh:**

1. **Guido Ottolenghi**, i biri i Emilio, lindur ne Bolonje, Italia, me 25 mars 1966, shtetas italian, me banim ne Bolonje, Itali, mbajtes i Pasaportes nr. 845811M, leshuar nga Kuestura e Bolonjes, me 20 shkurt 2001, DREJTOR I PERGJITHSHEM.
2. **Ing. Teuta Dobi**, e bija e Osmanit, lindur ne Tirane, Shqiperi, me 17.12.1959, shtetase shqiptare, me banim ne Tirane, mbajtese e Pasaportes, n o.1707269, leshuar nga Ministria e Brendeshme te Shqiperise, me 8 gusht 2000.
3. **Ing. Giovanni Cardamone**, i biri i Giocchinino-s, lindur ne Nicastro ( CZ ), Itali, me 18.11.1940, shtetas italian, me banim ne Milano, me Passaporto no.087700L, leshuar nga Questura e Milanos, me 26 tetor 1993.

#### **Neni 8 Ushtrimi financiar**

Ushtrimi financiar fillon me 01 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti kalendarik. Perjashtim ben ushtrimi i pare financiar, i cili fillon nga dita e rregjistrimit ne Regjistrin Tregetar prane Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Gjyqesor Tirane dhe mbyllet me 31 Dhjetor '02.

#### **Neni 9 Redaktimi i Kontrates**

Kjo kontrate eshte redaktuar ne gjashte (6) kopje originale ne te dy gjuhete, shqip dhe italisht, te barabarte nga vlera per efektet juridike te tyre. Ne rast te mosperputhjes ne interpretimin e tyre do te kete prioritet ajo e shkruar ne gjuhen italiane.

#### **Neni 11 Hyrja ne fuqi**


Kjo kontrate gjendet ne pajtim me vullnetin e aksionerit te vetem dhe hyn ne fuqi, sot ne daten e nenshkrimit te saj.

**Lexuar, aprovuar, nenshkruar.**

### **AKSIONERI THEMELUES**

**Shoqeria anonime "LA PETROLIFERA ITALO RUMENA" S.p.A.**

**Perfaqesuesi Ligjor: GUIDO OTTOLENGHI**

GUIDO OTTOLENGHI 

**Perktheu: Av. Lisenko Moçka**

**Çertifikate e Rregjistrimit ne Organin Tatimor**

**Kodi fiskal nr.3808672 nr.serial 0049187**



# STATUTI

## I

### SHOQERISE ANONIME PA OFERTE PUBLIKE “ LA PETROLIFERA ITALO-ALBANESE” SH.A.

#### Kapitulli I

##### Themelimi - qendra legale - objekti -- kohezgjatja

**Neni 1)-** Themelohet nje shoqeri anonime pa oferte publike, me aksione, e emertuar LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE SH.A.

**Neni 2)-** Shoqeria ka qendren e saj legale ne Tirane, Rr.Durresit, nr.1, prane Tirana Trade Center.

Shoqeria mund te transferoje qendren e saj edhe ne ndonje vend tjeter, por vetem brenda territorit te Republikes se Shqiperise dhe mund te themeloje edhe jashte vendit qendra dytesore, agjensi, stabilimente te prodhimit dhe zyra.

**Neni 3)-** Shoqeria ka per objekt, te ushtroje veprimtarine e saj ne perputhje me Ligjin nr.8450/1999, date 24 shkurt :

- Depositat, transporti, transformimi dhe perpunimi i produkteve te naftes, kimike, te gazit te lengshem te naftes (GLN), ushqimore, te bitumit dhe te produkteve te lengshem ne pergjithesi, si dhe te gjithë produktet e tjere te paamballazhuar ( ne rifuxho );

- realizimin dhe ushrimin e veprimtarise se cisternave per depozitim dhe te magazinave bregdetare dhe ne brendesi tokesore;

- studimin, eksperimentimin, projektimin dhe realizimin e ndryshimeve dhe te modernizimeve te impianteve, realizimin e te gjitha iniciativave te drejtimit qe kane lidhje me permiresimin funksional dhe ekonomik te veprimtarise logjistike, duke mbajtur gjithmone parasysh aspektet ekologjike dhe te sigurimit;

Shoqeria ka, gjithashtu, per objekt, jo ne menyre ekskluzive ose prevalente, marrjen persiper te pjesemarrjes ne shoqerite industriale, tregtare, financiare, ne pergjithesi, si ne ato shqiptare ashtu edhe ne ato te huaja dhe, qerane financiare te sendeve te paluejtshem dhe te luejtshem.

Shoqeria, gjithashtu, mund te kryeje cdo dhe cfardo veprimi tregetar industrial, financiar dhe veprime imobiliare, si dhe sa Asamblea ose Keshilli Mbikqyres do t'i konsiderojne te nevojshem per arrijten e objektit te shoqerise .

**Neni 4)-** Kohezgjatja e shoqerise percaktohet nga data e Aktit te Themelimit deri me 31 dhjetor 2100.

#### KAPITULLI II

##### Kapitali Themeltar

**Neni 5)-** Kapitali Themeltar eshte fiksuar prej leke shqiptare 2.000.000 ( dymilion) te barabarte ne ekuivalence ne EURO ..... ( ditën e nenshkrimit te ketij akti ), te ndare ne 200 ( dyqind ) aksione te zakonshm, me vlere nominale prej leke shqiptare 10.000 ( dhjetemije ) secili.

**Neni 6)-** Aksionet jane nominative. Nese ligja lejon, aksionet mund te transformohen nga tek pruresi ose anasjelltas, me kerkesen dhe shpenzimet e aksionerit dhe me modalitetet e percaktuara nga organi kompetent i shoqerise. Ne cdo rast, te gjithë aksionet e emetuara nga shoqeria duhet te

regjistruhen gjithmone ne librin e aksionereve, sipas natyres dhe zerave te pasurise, si ne rastin e aksioneve tek pruresi (ne kete rast duke qene pasuria anonime do te perdoret nje simbolike ose numere te zoterimit te tyre), si ne rastin e aksioneve nominative.

**Neni 7)** Cdo aksioner i zakonshem atribuon te drejten e nje vote ne vendimet e Asamblese se Zakonshme dhe te Jashtezakonshme .

**Neni 8)** Vendqendrimi i secilit aksioner prezumohet i percaktuar prane qendres legale te shoqerise.

**Neni 9)** Kapitali Themeltar mund te zmadhohet sipas percaktimit qe behet ne ligj.

### KAPITULLI III Asamblete

**Neni 10)** Asamblete mund te thirren si ne qendren legale te shoqerise ashtu edhe ne vende te tjera, si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj. Asambleja e zakonshme duhet te thirret se paku nje here ne vit brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor. Thirrja e asamblese behet nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres, i cili eshte i detyruar te marre masat e duhura mbi kerkesen e se paku dy anetareve te Keshillit Mbikqyres, ose nga Drejtori i Pergjithshem ose nga personat e treguar ne artikullin 132 te ligjit nr.7638, 19/09/1992. Thirrja e asamblese kryhet nepermjet nje njoftimi publik se paku 15 dite perpara dates te parashikuar per asamblene, se paku ne nje gazete te autorizuar per te publikuar njoftime legale, pervec se kur shoqeria nuk ka emetuar vetem aksione nominative ose te kete vetem nje aksioner; ne kete rast njoftimi mund t'i dergohet secilit aksioner me leter rekomande ne vend te publikimit. Ne cdo rast parashikohet qe aksioneret me banim jashte shtetit, titullare te aksioneve nominative, duhet te njoftohen per thirrjen e asamblese me rekomande me kthim pergjigje, ose nepermjet faksit me konfirmim te marrjes njoftim edhe ne rastin e publikimit ne nje ose disa gazeta. Shkelja e ketij rregulli shkakton pavlefshmerine e vendimeve te asamblese. Asamblete drejtohen nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres, ose ne mungese apo ndalim te tij, nga Zv/Kryetari i Keshillit Mbikqyres ose ne mungese apo ndalim te ketij te fundit, nga Drejtori i Pergjithshem. Asamblea emerone nje sekretar, pervec se kur proces-verbali redaktohet nga nje noter.

**Neni 11)** Kane te drejte per te marre pjese ne mbledhjen e Asamblese aksioneret e regjistruar ne Librin e Aksionereve se paku pese dite para dates te fiksuar per mbledhjen e saj, te cilet duhet te kene depozituar aksionet e tyre prane arkës se shoqerise ose prane nje shoqerie krediti ne afatet dhe ne menyrat e percaktuara ne njoftimin e thirrjes dhe, kur egzistojne arsione tek pruresi, poseduesit e tyre duhet te kene vepruar ne perputhje me rregullat e percaktuara per depozitim. Aksioneri mund te perfaqesohet ne asamble, sipas percaktimit ne ligj dhe delegimi mund te shkruhet mbi nje model te pranuar nga asamblea.

**Neni 12)** Asamblete jane te zakonshme dhe te jashtezakonshme. Asamblea e zakonshme aprovon bilancin vjetor, vendos mbi destinacionin e fitimeve, emerone anetaret e Keshillit Mbikqyres dhe vendos mbi te gjithë objektet e tjere qe kane te bejne me drejtimin e shoqerise, te cilat ligji ia rezervon asaj per kompetence, si dhe ato qe paraprakisht shqyrtohen nga Drejtoria ose Keshilli Mbikqyres.

Asamblea e jashtezakonshme thirret per vendimet qe kane lidhje me ndryshimet e Aktit te Themelimit dhe te Statutit, si dhe per vendimet e tjera te kompetences se saj sipas ligjit ose kur Keshilli Mbikqyres ose Drejtoria i konsiderojne te nevojshem.

**Neni 13)** Asamblea e zakonshme me thirrjen e pare konsiderohet e vlefshme me pranine e aksionereve qe perfaqesojne se paku ¼ e kapitalit themeltar, qe kane te drejten e votes. Asamblea

*Uall*

vendos ne menyre te vlefshme me voten e shumices qe zoterojne aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar.

Me thirrjen e dyte asamblee e zakonshme vendos me shumicen e votave, cilado qe te jete pjesa e kapitalit te perfaqesuar nga aksioneret pjesemarrres ne kete asamble.

Asamblee e jashtezakonshme me thirrjen e pare konsiderohet e rregullt me prezencen e aksionereve qe perfaqesojne se paku gjysmen e kapitalit themeltar me te drejte vote dhe, ne mbledhjen e dyte, me pranine e aksionereve qe perfaqesojne se paku  $\frac{1}{4}$  e kapitalit themeltar qe kane te drejten e votes. Ajo merr vendim me nje shumice votash prej  $\frac{3}{4}$  qe u perkasin aksionereve te pranishem.

**Neni 14)-** Vendimet e asamblese merren gjithmone me vota te hapura, duhen te pasqyrohen ne proces-verbalin e nenshkruar nga kryesuesi dhe nga sekretari ose nga noteri, sipas rastit kur jane te zakonshme apo te jashtezakonshme. Ne proces-verbale pasqyrohen ne menyre te permblledhur deklarimet e aksionereve, sipas kerkeses se bere prej tyre. Proces-verbale redaktohen ne dy gjuhe shqip dhe italisht, me vlere te barabarte per efektet juridike te tyre. Ne rast mosperputhje te interpretimit do te kete perparesi ai i shkruar ne gjuhen italiane.

Proces-verbale e asambleve shkruhen ne libra te posatcem dhe duhen te firmosen nga kryesuesi dhe sekretari ose nga noteri.

**Neni 15)-** Kryesuesi i asamblese ka fuqi te plota per te verifikuar regullsiine e mbledhjes dhe ne pergjithesi, te drejten e aksionereve per te marre pjese ne te, per te konstatuar vlefshmerine e asamblese, per te drejtuar dhe rregulluar diskutimet dhe per te vendosur menytrat e votimit.

**Neni 16)-** Vendimet e asamblese te marra ne perputhje me ligjin dhe statutin jane te detyrueshme per te gjitha aksioneret, te cilet edhe mund te mos jene prezent ose mund te jane kunder.

## **KAPITULLI IV**

### **Keshilli Mbikqyres**


**Neni 17)-** Keshilli mbikqyres perbehet nga nje minimum antaresh prej tre dhe maksimum deri ne gjashte persona, te cilet mund te mos jene ortake;  $\frac{2}{3}$  te emeruar nga asamblee dhe  $\frac{1}{3}$  nga nepunesit e shoqerise. Anetaret e keshillit mbikqyres nuk mund te jene administratore te saj. Ata kane nje mandat me kohezgjatje dy vjet dhe mund te rizgjidhen. Asamblee percakton shperblimet e tyre.

**Neni 18)-** Keshilli mbikqyres, nese asamblee nuk parashikon, zgjedh ndermjet anetareve te saj nje Kryetar dhe nje zv/Kryetar dhe emerone nje sekretar. Ky i fundit mund te mos jete anetar i keshillit.

**Neni 19)-** Keshilli mbikqyres thirret dhe drejtohet nga kryetari ose ne mungese te tij nga zv/kryetari. Keshilli mbikqyres mund te thirret edhe ne nje vend te ndryshem nga qendra legale e shoqerise, ne Shqiperi ose jashte saj.

**Neni 20)-** Keshilli mbikqyres konsiderohet se eshte mbledhur ne menyre te vlefshme me prezencen e shumices se anetareve te tij dhe vendimet e marra jane te vlefshme nese jane marre me shumicen e votave te te pranishmeve; ne rast te barazise se votave, ajo e kryetarit te Keshillit Mbikqyres ose te atij qe e zevendeson eshte dominuese. Te gjitha vendimet e keshillit duhet te pasqyrohen nga nje proces-verbal i nenshkruar nga kryetari ose ai qe e zevendeson dhe nga sekretari. Proces-verbale redaktohen ne dy gjuhe, shqip dhe italisht, me vlere te barabarte per efektet juridike te tyre. Ne rast te nje mosperputhje te interpretimeve, ka perparesi ai i shkruar ne gjuhen italiane.

**Neni 21) –** Keshillit Mbikqyres i atribuohen pushtetet e percaktuara ne baze te ligjit.



**Neni 22)** Keshilli Mbikqyres perbehet nga tre anetare, te cilet jane emruar me nje mandat me kohezgjatje prej dy vjetesh, prej personave ne vazhdim :

1. Dr. Emilio Ottolenghi, i biri i Guido-s, lindur ne Torino ( To.), Itali, me 18.01.1932, shtetas Italian, me banim ne Minerbio (BO), mbajtes i Pasaportes nr. 816594L, leshuar nga Kuestura e Bolonjes, me 30.06.1934, KRYETAR.
2. Prof. Av. Marco Lamandini, i biri i Lucianos, lindur ne Bologna ( Bo.), Itali, me 03.07.1966, shtetas Italian, me banim ne Milano ( Mi. ), mbajtes i pasaportes nr 319913B, leshuar nga Kuestura e Bolonjes, me 09.07.1998, ZEVENDESKRYETAR.
3. Ing. Giancarlo Magnani, i biri i Armandos, lindur ne Milano ( Mi. ), Itali, me 29.05.1939, shtetas Italian, me banim ne Genova, Itali, mbajtes i pasaportes nr. 096584P, leshuar nga Kuestura e Genoves, me 19.09.1996.

## KAPITULLI V

### Drejtoria

**Neni 23)** – Shoqeria administrohet nga nje Drejtori e perbere nga nje minimum prej dy ( 2 ) dhe nga nje maksimum prej gjashte ( 6 ) anetaresh, dhe jo ortake, te emeruar nga Keshilli Mbikqyres, i cili percakton here pas here numurin e tyre, emerone Drejtorin e Pergjithshem, si edhe shperblimet perkatese.

Anetaret e Drejtorise kane nje mandat me kohezgjatje prej 2 vjete dhe rizgjidhen.

**Neni 24)** – Drejtoria percakton pushtetet e Drejtorit te Pergjithshem dhe emerone nje sekretar, i cili mund te mos jete anetar i drejtorise. Drejtoria percakton, gjithashtu, edhe shperblimin per Drejtorin e Pergjithshem dhe per anetaret e tjere, si dhe detyrat e tyre.

**Neni 25)**- Mbledhja e Drejtorise thirret nga Drejtori i Pergjithshem, ose ne mungese te tij nga dy anetare te Drejtorise. Ajo drejtohet nga Drejtori i Pergjithshem ose nga anetari me i vjeter i saj. Drejtoria mund te thirret edhe ne vende te ndryshme nga qendra legale e shoqerise edhe jashte territorit te vendit.

**Neni 26)** – Vendimet e Drejtorise merren me shumicen absolute te votave; ne rast te barazise se votave ajo e Drejtorit eshte dominante. Te gjitha vendimet e Drejtorise duhet te pasqyrohen ne nje proces-verbal te nenshkruar nga Drejtori i Pergjithshem ose nga ai qe e zevendeson, sikunder permend neni 25 dhe nga sekretari. Proces-verbalet redaktohen ne dy gjuhe, ne shqip dhe ne italisht, me vlere te barabarte per efektet juridike.. Ne rast te nje mosperputhje ne interpretimin e tyre do te kete perparesi ai i shkruar ne gjuhen italiane.

**Neni 27)** – Drejtorise i atribuohen pushtetet me te gjere dhe te pakufizuar, te administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem, si dhe te disponimit, me perjashtim te atyre objekteve, te rezervuara ne menyre te pandryshueshme qe ne baze te ligjit jane ne kompetence te Keshillit Mbikqyres ose te asamblese.

**Neni 28)** – Perfaqesimi i shoqerise i takon vecanerisht Drejtorit. Perfaqesimi u takon, gjithashtu, edhe anetareve te tjere te Drejtorise, por me kushtin qe te veprojne me firme te perbashket se paku te dy prej tyre.



**Neni 29)** – Anetaret e Keshillit Mbikqyres dhe te Drejtorise duhet te permbushin detyrat e tyre te percaktuara nga ligji dhe nga akti i themelimit, me kujdesin e perfaqesuesit dhe jane solidarisht pergjegjes ndaj shoqerise per demet e shkaktuara nga mosplotesimi i tyre, perverse kur trajtohen si attribute te percaktuara te nje apo disa anetareve te Drejtorise. Ne cdo rast, anetaret e Drejtorise jane solidarisht pergjegjes nese nuk kane kontrolluar mbi ecurine e pergjitheshme te drejtimit dhe se, duke qene ne dijeni te veprimeve qe e demtojne shoqerine, nuk kane bere ate qe duhej te benin per eliminimin e tyre ose per te zbutur efektin demtues te tyre. Pergjegjesia per veprimet apo mosveprimet e anetareve nuk shtrihet per ate qe nder te tjeret, i perjashtuar nga faji, ka shenuar pa vonese mosaprovimin e tij ne librin e Drejtorise dhe ka njoftuar menjehere Keshillin Mbikqyres. Anetaret e Drejtorise pergjigjen ndaj kreditorëve te shoqerise per mospembushjen e detyrimeve qe kane lidhje me ruajtjen e paprekshmerise se pasurise se shoqerise. Pergjegjesia e anetareve nuk shtrihet per aktet dhe veprimet e kryera prej tyre, dhe ne menyre te vecante per oportunitetin dhe leverdine e tyre.

**Neni 30)-** Drejtoria perbehet nga tre (3) anetare, te cilet jane emeruar me nje mandat me kohezgjatje prej dy ( 2 ) vjetesh:

1. Guido Ottolenghi, i biri i Emilio, lindur ne Bolonje, Italia, me 25 mars 1966, shtetas italian, me banim ne Bolonje, Itali, mbajtes i Pasaportes nr. 845811M, leshuar nga Kuestura e Bolonjes, me 20 shkurt 2001, DREJTOR I PERGJITHSHEM.
2. Ing.Teuta Dobi, e bija e Osmanit, lindur ne Tirane, Shqiperi, me 17.12.1959, shtetase shqiptare, me banim ne Tirane, mbajtese e Pasaportes, no.1707269, leshuar nga Ministria e Brendeshme te Shqiperise, me 8 gusht 2000.
3. Ing. Giovanni Cardamone, i biri i Giocchinino-s, lindur ne Nicastro ( CZ ), Itali, me 18.11.1940, shtetas italian, me banim ne Milano, me Passaporto no.087700L, leshuar nga Questura e Milanos, me 26 tetor 1993.

## **KAPITULLI VI**

### **Bilanci dhe ndarja e fitimeve**

**Neni 31)** – Vitet ushtrimore mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti.

**Neni 32)** – Me mbylljen e cdo viti ushtrimor, drejtoria do te redaktoje inventarin me kritere te percaktuar me shume kujdes dhe ne baze te atyre te percaktuara nga ligji, si dhe do te hartoje brenda afateve ligjore, bilancin e vitit ushtrimor me llogarite e perfitimeve dhe te humbjeve, per t'ia paraqitur per miratim Keshillit Mbikqyres dhe asamblese.

**Neni 33)** – Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci, duke zbritur 5 perqind te tyre, te destinuar per t'i vendosur ne fondin e rezerves ligjore, derisa ky fond te arrije ne masen e 10 perqind te kapitalit themeltar, do te ndahen ndermjet aksionisteve, perverse kur asamblea e zakoneshme vendos ndryshe.

## **KAPITULLI VII**

### **Eksperti kontabel i autorizuar**

**Neni 34)** – Kontrolli kontabel kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i cili emerohet cdo vit nga asamblea e ortakeve ne baze te ligjit shqiptar.





## KAPITULLI VIII Likujdimi

**Neni 35)** Në rastin e prishjes së shoqërisë, asambleja do të emerojë një ose disa likuidatore, të cilet do të veprojnë në bazë të ligjit.

## KAPITULLI IX Arbitrazhi

**Neni 36)** Çdo mosmarrëveshje që do të mund të lindin ndërmjet shoqërisë dhe aksionerëve, anëtarëve të Drejtorisë, anëtarëve të Këshillit Mbikqyres, likuidatorëve dhe të gjithë personave të tjerë të përmendur në këtë statut, do të zgjidhen sipas vendimit të një këshilli arbitral i përbërë nga tre anëtarë, të emëruar një nga çdo palë dhe i tretë me marrëveshje të përbashkët ose, në të kundërtën nga Kryetari i Gjykatës së Milanos, nga pala që e kërkon me shpejt. Në çdo rast, kolegji i arbitrave duhet të vendosë sipas equita, me modalitete të një arbitrimi jo të zakonshëm, pa formalitete të procedurës, por me respektimin e plotë të parimit të kontradiktorialitetit dhe vendimi i tij, do të jetë i paapelueshem.

## KAPITULLI X Dispozita Perfundimtare

**Neni 37)** Për gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut, do të zbatohen në referim dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.12.1992 "Për shoqëritë tregtare", ato të Kodit Civil dhe ligjeve të tjera në fuqi, në lëndën e shoqërive me aksione.

**Neni 38)** Ky statut është redaktuar në gjashtë (6) kopje origjinale në të dy gjuhët, shqip dhe italisht, të barabartë nga vlera për efektet juridike. Në rast të mospërputhjes në interpretimin e tyre do të ketë prioritet ajo e shkruar në gjuhën italiane.

**Lexuar, aprovuar, nënshkruar.**

**Per Shoqërinë LA PETROLIFERA ITALO RUMENA S.p.A.  
Perfaqësuesi Ligjor: Dr. Guido OTTOLENGHI**

GUIDO OTTOLENGHI 

**Perktheu: Av. Lisenko Moçka  
Çertifikatë e Rregjistrimit në Organin Tatimor  
Kodi fiskal nr.3808672 nr.serial 0049187**

